REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**PREFEKTI I QARKUT SHKODER**

Nr. 522/1 prot.

Shkodër, më 7.08.2023

**Lënda:** Mbi vendimin Nr. 56, datë 27.07.2023 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 24, neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar, neni 20, neni 30, pika 1, të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit", pika 190, të Udhëzimit Plotësues të MFE nr. 2, datë 19.01.2023 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023", të Udhezimit të MFE nr. 35, datë 21.09.2020 "Për kontrollin, regjistrimin, përdorimin, rakordimin, raportimin, dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrveshjeve ndërkombëtare", Marrëveshjes standarte me Nr.4166 prot., datë 06.07.2023 mes UNDP dhe Bashkisë Vau Dejës "*Mbi zbatimin e programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas", faza 2/LNB2 ku UNDP ka rolin e palës zbatuese*, shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 4740 prot., datë 02.08.2023 "Mbi dokumentacionin e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, datë 27.07.2023", shqyrtoi *VKB Vau Dejës nr. 56, datë 27.07.2023 "Për miratimin e shtesës së planit në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me VKB nr. 84, datë 23.12.2022* me shtesë plani në buxhet në programin 10430 "Kujdesi Social", me shumën 2.995.419 lekë, për projektin "Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale dhe shëndetësore për femijët me aftësi të kufizuar dhe ekstremisht të varfër", me financim nga programi i UNDP në shumën 2.352.000 lekë, ndërsa shuma 643.419 lekë është si bashkëfinancim i Bashkisë Vau Dejës sipas VKB Vau Dejës Nr. 84, datë 23.12.2022 "*Për miratimin e buxhetit te vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2023-2025*".

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**P R E F E K T I**

**Majlinda ANGONI**

Adresa: "Rruga 28 Nëntori" Shkodër, Telefon/Faks +355 2224 2705, e-mail: Prefekti.Shkoder@mb.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

Nr. 56 datë 27.07.2023

**"Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me VKB nr 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjesve për Bashkinë Vau Dejës"**

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja "d", nenit 54 shkronja "dh", të ligjit nr. 139 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat vendore"; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Marrveshjes Standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë së Vau Dejës, mbi zbatimin e programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetët pas"Faza 2/ LNB2 ku UNDP ka rolin e palës zbatuese, me nr. 4166 Prot, datë 06.07.2023.VKB-së nr 84, datë 23.12.2023 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës", i ndryshuar, Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës;

**KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D O S I**

**1.** Miratimin shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës për vitin 2023 sipas relacionit bashkëngjitur

**2.** Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**3.** Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**
**Ardian Celepija**

**ZV/K R Y E T A R KESHILLIT**
**Paola Pleshaj**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VAU DEJËS

Miratuar me 16 vota
Vota Pro 16
Vota Kunder –
Vota Abstenim –
Zbardhur me datë 01.08.2023

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, Telefon/Faks 00355 2612 0006, e-mail: info@vaudejes.gov.al*

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**

**K R Y E T A R I**

*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, nr Tel : 00355 2612 0006, e-mail info@vau dejes.gov.al*

Nr. 4452/1 prot. Vau Dejës,më 19 / 07 /2023

Lënda: Dërgohet për shqyrtim e miratim projekt – vendimi dhe relacioni

**Z. Ervis Shimaj**

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJES**

**I nderuar zoti Kryetar,**

Bashkëngjitur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin: "Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës të miratuar me VKB nr 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjesve për Bashkinë Vau Dejës"

Duke ju uruar pune të mbarë.

Me respekt

**KRYETARI**
**Kristian Shkreli**

**Miratoi:**

Ridvan Luzaku: Drejtor/ Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.

Elsa Sema: Drejtor/ Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar.

Bib Mirija: Drejtor/ Drejtoria Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve.

**Konceptoi:**

Celco, Babani: Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

Datë: ___________

Nr. i faqeve A4 të projekt-vendimit: ____

Nr. i faqeve A4 të relacioni shoqërues: ____

Nr. i fletëve të dokumenteve që shoqërojnë projekt vendimin: ____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA VAU DEJËS**
*Adresa: Rruga "Qafa e Gurit" Vau Dejës, nr Tel : 00355 2612 0006, e-mail info@vau dejes.gov.al*

**Nr 4452 Prot** **Vau Dejës më 19/07/2023**

**PROJEKT VENDIM**

Nr 09 datë 19.07.2023

**"PËR MIRATIM SHTESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS TË MIRATUAR ME VKB NR 84, DATË 23.12.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2023-2025, NUMRIN E PUNONJESVE PËR BASHKINË VAU DEJËS" I NDRYSHUAR.**

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja "d", nenit 54 shkronja "dh", të ligjit nr. 139 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat vendore"; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Marrveshjes Standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë së Vau Dejës, mbi zbatimin e programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetët pas"Faza 2/ LNB2 ku UNDP ka rolin e palës zbatuese, me nr. 4166 Prot, datë 06.07.2023.VKB-së nr 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës", i ndryshuar, Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

**VENDOSI**

1. Miratimin shtesës së planit të buxhetit të bashkisë Vau Dejës, për projektin "Ofrimi i Shërbimeve të Integruara Sociale dhe Shëndetësore për fëmijët me Aftësi të kufizuar dhe ekstremisht të varfër". Projekti financohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim nën thirrjen "ASKUSH TË MOS MBETET PAS (LNB2)" Grante për Shërbime Shoqërore me Baze Komunitare. Ky projekt do të përfshihet në programin 10430 "Kujdesi Social" shuma 2,994,419.0 (dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e kater mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë )lekë sipas detajimit me poshtë:

| Shpenzimet e llogaritura | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet për çdo aktivitet** | **Totali** | | | | | | |
| **Shuma 2023** | **(Lek)** | Paga | Sigurime shoq+ shënde | Tatimi në Burim | Shpenzime Operative | Transferime | Kapitale |
| **TOTALI** | **2,057,710** | 715,200 | 31,996 | 92,400 | 418,114 | | 800,000 |
| **Shuma 2024** | | | | | | | |
| **TOTALI** | **937,709** | 715,200 | 31,996 | 92,400 | 98,113 | | |
| **Shuma totale e financuar nga projekti** | **2,352,000.0** | | | | | | |

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETAR**
**Kristian Shkreli**

**Miratoi:**

______________: Drejtor/ Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.

______________: Drejtor/ Drejtoria Ekonomike dhe Menaxhimi Financiar.

______________: Drejtor/ Drejtoria Juridike e Integrimit Prokurimeve dhe Aseteve.

**Konceptoi:**

______________; Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJES**

**K R Y E T A R I**

**Vau Dejës, më 18/07/2023**

**Nr.4468 Prot**

# RELACION

## "PËR MIRATIM SHTESË PLANI NË BUXHETIN E BASHKISË VAU DEJËS TË MIRATUAR ME VKB NR 84, DATË 23.12.2022 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2023 DHE PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM PERFUNDIMTAR 2023-2025, NUMRIN E PUNONJESVE PËR BASHKINË VAU DEJËS" I NDRYSHUAR.

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau Dejës**

**Të nderuar Këshilltarë!**

Në mbështetje të nenit 35 pika 1 shkronja "d", nenit 54 shkronja "dh", të ligjit nr. 139 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; ligji nr 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; neni 20 pika 1 dhe 5, të ligjit nr. 68/2017 "Për Financat vendore"; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar; ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" të ndryshuar; pika 190 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" i ndryshuar; Marrveshjes Standarte mes Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Bashkisë së Vau Dejës, mbi zbatimin e programit të përbashkët të kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetët pas"Faza 2/ LNB2 ku UNDP ka rolin e palës zbatuese, me nr. 4166 Prot, datë 06.07.2023.VKB-së nr 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës", i ndryshuar, *ju dërgojmë këtë relacion* "Për miratim shtesë plani në buxhetin e Bashkisë Vau Dejës miratuar me VKB nr 84, datë 23.12.2022 "Për miratimin e Buxhetit të Vitit 2023 dhe programit buxhetor afatmesem perfundimtar 2023-2025, numrin e punonjësve për Bashkinë Vau Dejës", i ndryshuar, Për projektin "Ofrimi i Shërbimeve të Integruara Sociale dhe Shëndetësore për fëmijët me Aftësi të kufizuar dhe ekstremisht të varfër" nën thirrjen "ASKUSH TË MOS MBETET PAS (LNB2)" Grante për Shërbime Shoqërore me Baze Komunitare, ku Bashkia Vau Dejës është shpallur fituese.

Ky projekt ka një vlerë totale prej 2,995,419.0 (Dy milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë) lekën me Tvsh, nga të cilat donatori do te financojë shumën, 2,352,000,0 (Dy milion e treqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë me Tvsh, ndërsa kontributi i Bashkisë Vau Dejës do të jetë si bashkëfinancim në masën 21.48% në vlerën 643,419.0 (gjashtëqind e dyzet e tre mije e katërqind e nëntëmbëdhjetë )lekë me Tvsh.

Bashkefinancimi me fondet e bashkisë për vlerat 643,419 (Gjashtëqind e dyzet e tre mije e katërqind e nëntëmbedhjetë) lekë është i ndarë në vlerën 321,710 (treqindë e njëzet e një mijë e shtatëqind e dhjetë ) lekë për vitin 2023 dhe 321,709 (treqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e nentë) leke për vitin 2024,

Vlera prej 321,710 (treqindë e njëzet e një mijë e shtatëqind e dhjetë) për vitin 2023, detajohet si vijon

a) 223,596 Lekë shpenzin për paga dhe sigurime shoferi (staf ekzistues i bashkise pozicioni aktual shofer)

b)98,114 Lekë shpenzime për karburat. Ky shpenzim do kaloj nga llogaria 06260 (Sherbime Publike) në llogarinë 10430 Kujdesin Social

Vlera prej 321,710 (treqindë e njëzet e një mijë e shtatëqind e dhjetë) për vitin 2024, Bashkia Vau Dejës merr përsipër angazhimin që kjo vleren si bashkefinancim, ta parashikojë më kërkesat buxhetore në PBA 2024-2027 dhe ta vendos në dispozicion të zbatimit të projektit.

Financimi nga donatori do të bëhet në dy faza/këste. Kesti i parë me vlerën 1,736,600 (një milion e shtatëqind e tridhjete e gjashtë mijë e gjashtëqind) Lekë , dhe kësti i dytë do të dergohet nga donatori pas kerkesë realizuar ne dhjetor 2023 .

Me anë të këtij financimi është planifikuar të realizohet, Burime njerëzore, shofer (staf i ekzistues i bashkise) + kontraktimi i nje psikologu dhe fizioterapisti me kontrate punë, të cilët do të ofrojnë seanca psikologjike dhe fizioterapiet për 28 fëmije më Aftësi të kufizuar dhe ekstremishtë te varfër, në shumën 1,679,192 (Një milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e nëntë mije e njëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë. Pajisje dhe furnizime, (shpenzime karburanti dhe blerje automjeti për transporti) ne shumën 996 227 (nentëqond e nëntëdhjetë e gjashtë mije e dyqind e njëzet e shtatë ) lekë; shpenzime për aktivitete (mjete pune për fizioterapistin dhe psikologun) ne shumën 200,000.0 (dyqind mijë )leke; vizibilitet, botime , përkthime ne shumën 120,000.0 (Njëqind e njëzet mijë)Lekë.

Gjithashtu ndër rezutatet e pritshme të realizimit të këtij projekti janë; ).Trajtimi i 28 fëmijeve me aftësi të kufizuar nëpërmjet terapise infividuale të psikologjike dhe fizioterapeutike. Përmirësimi shëndetëso dhe psikologjik i këtyre fëmijeve.

b) Aftësimi i prinderve për tu kujdesur sipas nevojave të vecanta që femijet kane duke bërë kështu të mundur progresin e terapise edhe pas masrrjes se saj. Koordinimi i punes në grup mes femijes me aftësi të kufizuar, krijimi i skedave të përsonalizuara të fëmijes nga psikologu dhe fizioterapisti, dhe prindit si dhe mësuesi mbështetës për fëmijet që ndjekin shkollën në mënyre

që shërbimi në vazhdimësi të ndikojnë pozitivisht në permiresimin dhe aftësimin e fëmijes për proceset jetesore bazike dhe jo vetem.

c). Ndërgjegjesimi i komuniteteve vulnerabel, por dhe stafeve të institucioneve kompetente për shërbimin edhe të përsonave me aftësi te kufizuar mbi rëndesine e ofrimit të shërbimeve të integruara psikologjike dhe shëndetësore, si një hap i drejtëpërdrejt në rritjen e aftësimit të këtyre kategorive për proceset jetësore.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

**KRYETAR**
Kristian Shkreli

Ridvan Luzaba ___________:Drejtor/Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social

# Fishe Projekti

| | |
|---|---|
| **Projekti UNDP nr 00126393**<br>**Aktiviteti 1.2.3** "Mbeshtetje për projektet për shërbimet të reja inovative në nivel lokal, në përputhje me rregulloren e skemës së granteve ". | **Programi: 10430** Kujdesi Social |

**Titulli i Projektit:**
"Ofrimi i shërbimeve të Integruara Sociale dhe Shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuar dhe ekstremisht të varfër"
**Mbështëtur nga:** Programi për zhvillim të Kombëve të Bashkuara (UNDP) "Leave no one behind/Askush të mos mbetet pas"(LNB2) dhe Bashkia Vau Dejës, po ju paraqesim për miratim planin e punes si me poshte:

1. **Përshkrimi i shkurtër i projektit:**

Në mbështetje të Planit Social 2021-2023 të Bashkisë Vau Dejës, i realizuar nën mbështetjen e UNICEF përmes programit "Leave No One Behind" dhe konsulentë të "ESA Consulting" struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror në këtë Bashki nisi në maj 2020 procesin e hartimit të Planit Social 2021-2023. Hartimit të këtij Plani i parapriu Raporti i Vlerësimit të Nevojave për Shërbime të Kujdesit Shoqëror, i cili identifikoi grupet në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e Bashkisë, madhësinë e këtyre grupeve, shtrirjen e tyre në territor, shërbimet egzistuese që adresojnë nevojat e tyre, si dhe kapacitetet e burimet njerëzore e financiare të Bashkisë për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Nisur nga kjo Bashkia Vau Dejës nëpërmjet këtij projekti synon që të vendosi në zbatim një nga prioritete kryesore të këtij Plani, që është edhe ofrimi i shërbimeve të integruara shëndëtësore, psikologjike për fëmijet me aftësi të kufizuar. Në Bashkinë Vau Dejës nuk ka mjaftueshëm kapacitete profesionale (psikolog, fizioterapist, etj) për të ndihmuar këtë kategori dhe nëpërmjet këtij projekti ne synojmë të dërgojmë profesionist pranë këtyre fëmijeve për të ofruar këtë shërbim në banesë, pasi mungojnë qendrat për këto shërbime, transporti publik ndërqyteras dhe fshatrash,si dhe varfërie në të cilën gjenden familjet e këtyre fëmijeve dhe pamundësia e tyre për të levizur për marrjen e shërbimeve të tilla. Aftësimi i prinderve për mënyrat e trajtimit të fëmijeve sipas nevojave të tyre, si dhe ndergjegjesimi i stafeve të institucioneve arsimore, shendetesore dhe komuniteve të varfëra të bashkinë tonë, për rendësinë që ka ofrimi i shërbimeve të integruara për fëmijët me aftësi të kufizuar është një tjetër synim kryesor që neve synojme të arrijmë nëpërmjet këtij projekti.

2. **Situata**

Projekti i ndërtuar për të ofruar këtë lloj shërbimi vjen si pasoje e nevojes se madhe që ekziston në Bashkinë Vau Dejës për këto shërbime. Specifikisht fëmijet me aftësi të kufizuar nuk marrin asnje lloj sherbimi terapeutik. Shërbimi që ofrohet për to është vetem shpërndarja e KEMP-it. Duke ju referuar numrit të lartë të fëmijeve me aftësi te kufizuar të cilët ndodhen në situatë vulnerabel për shkak edhe të varferis së tyre, ku aktualisht kemi nje numer prej 112 fëmijet me aftësi të kufizuar në te gjithë territorin e Bashkisë Vau Dejës nga ku 98 prej tyre janë pjese e familjeve ekstremisht te varfera pa asnje te ardhe. Duke vlersuar ketë situate si dhe kapacitetin tone si bashki duke marre

| |
|---|
| mbështëtjen nga ky projekt bëhët e mundur që të ofrohet ky shërbim fillimisht vetem për 28 fëmije me aftësi të kufizuar që janë pjese e familjeve ekstremishtt të varfër pa asnje të ardhur në ndodhur në Njësinë Vau Dejës Qender, Njësia Administrative Hajmel, si dhe Njësia Administrative Bushat. Ofrimi i këtij shërbimi në banesë vjen si shkak i dhënies së mundësisë për gjithpërfshirje duke ul rrezikun e mos marrjes se shërbimit për shkak të pamundësis së familje për të levizur nga mungesa e transportit apo kushteve ekstremisht të varfera social ekonomike pasi shpërndarja gjeografike e banesa të tyre është ë madhe. Referuar situates vulnerabel në të cilën ndodhen familjet e këtyre fëmijeve, prinderit nuk kanë kapacitetin për ti trajtuar fëmijet sipas nevojave të vecanta të tyre dhe kjo gjë shkakton thellimin e demtimit fizik dhe mendor të tyre, dhe duke pare rendësinë që kanë stafet e institucioneve, shëndetësore apo arsimore ne ndergjegjesimin e komunitetit për rendesine e marrjes së shërbimeve kryesisht për këto kategori, çmojme shumë të rendësishmë informimin e tyre për rëndesine që ka ofrimi i shërbimeve të integrauara sociale dhe shendetësore. Vlersojmë që ky ndërgjegjësim do ndikojnë jo vetem ne pune e tyre të përditshme në përfshirjen e fëmijeve më aftësi të kuzifuar në aktivitete sociale gjithëpërfshirsë, por edhe ne lobimin që stafi do bëjë tek instancat me te larta, për të punësuar profesionist pranë institucinheve të tyre për ofrimin e shërbimevbe te tilla. Dukë krijuar kështu një rrjetëzim ofrimi shërbimesh në të ardhmen nga bashkia, institucionet, arsimore dhe shëndetësore. |
| **3. Synimi i projektit** |
| **1.** Ofrimi i Shërbimeve të Integruara Fizioterapeutike dhe Psikologjike në banesë për fëmijet me aftësi të kufizuar pjesë e familje ekstremisht të varfëra.<br>**2.** Ngritja e kapaciteteve të prinderve për trajtimin e fëmijeve nëpërmjet keshillave dhe informacioneve te drejtperdrejta nga psikologu dhe fizioterapisti.<br>**3.** Informimi i komuniteteve të varfera , institucioneve shkollave dhe qendrave shëndetesore për rendësine e ofrimit të shërbimeve të integruara, në zhvillimin e fëmijeve më aftësi të kufizuar |
| **4. Aktivitetet kryesore të projektit** |
| a) Ofrimi i këtij shërbimi në banësën e sescilit fëmije me aftësi të kufizuar, ku do alternohen dy senca psikologjike dhe dy senaca fizioterapiet ne muaj për secilin fëmijë .<br>b) Kontraktimi i fizioterapistit dhe psikologut për ofrimin e shërbimit, si dhe shoferi i automjetit.<br>c) Sigurimi i mjetit të transportit, karburantit, dhe çantës së punës për specialistët e fushave përkatëse.<br>d) Informimi i prinderve të fëmijeve përfitues nga profesionistet për rendesine e trajtimit të fëmijeve më aftësi të kufizuar si nga ana shëndetësore por dhe psikologjike, bazuar në nevojat specifike të fëmijës.<br>e) Krijimi i skedave të personalizuara per secilin fëmije si dhe detajimi i pershkrimit te punes edhe të prinderve me femijet në përditshmerine e tyre.<br>f) Takimi dhe informimi edhe i mesuesve mbeshtetës të fëmije që ndjekin shkollat për planin e ndëryrjes në mënyre që te bëhet një mirekoordinim i punes mes profesionistit (psikologut dhe fizioterapistit) me prindin dhe mesuesin mbështetës të fëmijes.<br>g) Shpërndarja e broshurave informuese dhe ndërgjegjësë për rëndësinë e ofrimit të shërbimeve psikologjike dhe shëndëtësore për fëmijër me aftësi të kufizuar tek komunitete të varfëra , |

# Fishe Projekti

| |
|---|
| institucionet arsimore, dhe qenderat shendetesore të Bashkisë Vau Dejës, në bashkëpunim më stafet e Drejtorise së Shërbimit Social të kësaj Bashkie.<br>h) Vendosja e stendave informuese për komunitetin mbi te drejtat, mbrojtjen dhe përfshirjen e fëmijeve më aftësi të kufizuar në jetën shoqërore në 4 Qendra Shendetësore (Vau Dejës, Bushat, Hajmel,Vig Mnel). |
| **5. Rezultatet që prisni** |
| a).Trajtimi i 28 fëmijeve me aftësi të kufizuar nëpërmjet terapise infividuale të psikologjike dhe fizioterapeutike. Përmirësimi shëndetëso dhe psikologjik i këtyre fëmijeve.<br>b) Aftësimi i prinderve për tu kujdesur sipas nevojave të vecanta që femijet kane duke bërë kështu të mundur progresin e terapise edhe pas masrrjes se saj. Koordinimi i punes në grup mes femijes me aftësi të kufizuar, krijimi i skedave të përsonalizuara të fëmijes nga psikologu dhe fizioterapisti, dhe prindit si dhe mësuesi mbështetës për fëmijet që ndjekin shkollën në mënyre që shërbimi në vazhdimësi të ndikojnë pozitivisht në permiresimin dhe aftësimin e fëmijes për proceset jetesore bazike dhe jo vetem.<br>c). Ndërgjegjesimi i komuniteteve vulnerabel, por dhe stafeve të institucioneve kompetente për shërbimin edhe të përsonave me aftësi te kufizuar mbi rëndesine e ofrimit të shërbimeve të integruara psikologjike dhe shëndetësore, si një hap i drejtëpërdrejt në rritjen e aftësimit të këtyre kategorive për proceset jetësore. |

| **6. Aktorët e mundshëm** | **7. Kontributet e mundshme në projekt** |
|---|---|
| **Bashkia Vau Dejës**<br>-Sektrori i ndihmes Ekonomike (administratori shoqeror)<br>-Stafi i Projektit<br>-Sektori i Sherbimit Social dhe Mbrojtjes se Femijeve.<br>-Sektori i Buxhetit dhe Finances<br>-Sektori i Burimeve Njerzore<br>-Sektori i Prokurimeve Publike | Vlera totale e projektit 2,995,419.0 (Dy milion e nenteqind e nentedhjete e pese mije e katerqind e nentembedhjete )Leke me Tvsh<br>Kontributi i (LNB2) ; 2,352,000.0 (Dy milion e treqind e pesëdhjete e dy mije)Leke me Tvsh<br>Kontributi i Bashkise Vau Dejes 643,419 (Gjashtëqind e dyzet e tre mije e katërqind e nentembedhjete )Leke me Tvsh. |

**8. Shpenzimet e llogaritura**

| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2023.** | Totali (Lekë) | **Nga kjo:** | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Paga | Sigurime | Tatimi ne burim | Operative | Transferime | Kapitale |
| **Burime Njerezore** | **839,596** | 715,200 | 31,996 | 92,400 | | | |
| *Kontribut Bashkia* | 223,596 | 191,600 | 31,996 | | | | |
| *Kontribut donatori* | 616,000 | 523,600 | | 92,400 | | | |
| **Pajisje dhe furnizime** | **898,114** | | | | 98,114 | | 800,000 |
| *Kontribut Bashkia* | | | | | 98,114 | | |
| *Kontribut donatori* | | | | | | | 800,000 |
| **Shpenzime per aktivitete** | **200,000.0** | | | | 200,000 | | |
| *Kontribut donatori* | 200,000 | | | | 200,000 | | |

# Fishe Projekti

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzime per vizibilitetin** | **120,000.0** | | | | 120,000 | | |
| *Kontribut donatori* | 120,000 | | | | 120,000 | | |
| **Shuma** | **2,057,710** | | | | | | |
| | | | | | | | |
| **Shpenzimet për çdo aktivitet 2024.** | Totali (Lekë) | **Nga kjo:** | | | | | |
| | | Paga | Sigurime | Tatimi ne burim | Operative | Transferime | Kapitale |
| **Burime Njerezore** | **839,596** | 715,200 | 31,996 | 92,400 | | | |
| *Kontribut Bashkia* | 223,596 | 191,600 | 31,996 | | | | |
| *Kontribut donatori* | 616,000 | 523,600 | | 92,400 | | | |
| **Pajisje dhe furnizime** | **98,113** | | | | 98,113 | | |
| *Kontribut Bashkia* | | | | | 98,113 | | |
| **Shuma** | **937,709** | | | | | | |
| **9.Periudha e zbatimit**<br>10-Muaj<br>Korrik 2023–Maj 2024 | **10.Përgaditi dhe ndjek realizimin e projektit:**<br>Stafi i Drejtorisë së Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.<br>Stafi i Drejtorisë së Ekonomike dhe Menaxhimit Financiar<br>Institucioni Likujdues: Bashkia Vau Dejës | | | | | | |